

Република Северна Македонија
Министерство за економија



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Ekonomisë



СТРАТЕШКИ ПЛАН PLANI STRATEGJIK VITI 2022- 2024 ГОДИНА



Почитувани,



Стратешкиот план претставува комплексен и сеопфатен документ кој содржи, мерки и активности групирани во програми и потпрограми, кои се во функција на остварување на стратешките приоритети и цели на Министерството за економија, а со тоа и на Владата на Република Северна Македонија.

Стратешкото планирање е алатка која има моќ, креираната визија да ја претвори во реалност. Оваа реалност преку стратешкото планирање веќе долги години успешно се спроведува во Министерството за економија.

Со стратешкото планирање се овозможува реализација на приоритети, цели и активности, кои ќе придонесат за развиена функционална економија, која ќе продуцира нови работни места, поголема ефикасност, продуктивност и конкурентност на компаниите, зголемување на извозот и пораст на инвестициите, повисок животен стандард и подобар живот за сите граѓани на Република Северна Македонија.

Стратешкиот план на Министерството за економија во наредните три години претставува рамка за на создавање на услови за развој на индустријата, на кластерингот, на вклучување на македонските компании во мрежата на глобални добавувачки ланци, креира мерки и активности за создавање на развиен претприемачки сектор, интеграција на националниот пазар во единствениот пазар на ЕУ, предлага политики за обезбедување на енергетска стабилност и сигурност, за истражување и одржливо искористување на минералните сировини, за развој на туризмот и угостителството, преку подобрување на стандардите и на туристичката понуда.

Изминатите неколку години беа направени клучни реформи во делот на подобрување на бизнис климата во земјата, подобрување на условите за работа на странските, но и домашните компании, како и за подобрување на деловната клима за нови инвестиции во енергетиката, пред се во делот на обновливите извори на енергија.

Сите овие реформи се направени преку континуиран дијалог со бизнис заедницата, со деловните здруженија, но и сите државни институции кои се креатори и имплементатори на економските политики, со единиците на локалната самоуправа, академската заедница, но и граѓаните.

Преку истиот дијалог веќе се зацртани и цели на кои активно ќе работиме и во наредниот период преку на нашите програми, проекти, мерки и активности.

Кои се приоритетите на Министерството за економија во наредниот период?

Главен приоритет е финансиска поддршка за компаниите со кои ќе се помогнат во спроведувањето со повеќедимензионалните последици од пандемијата предизвикана од Ковид-19, поттикнување на претпријатијата да излезат со иновативни решенија за справување со развојните предизвици кои произлегуваат од пандемијата. Согласно новите состојби со КОВИД 19, се подготвија повеќе уредби и нови мерки и програми со цел поддршка на деловниот сектор во надминување на негативните ефекти од кризата. Создавање на поволна деловна клима за бизнис секторот, пред се преку поддршка на домашните претпријатија, со главен фокус на малите и средните претпријатија, отворање на нови работни места преку нови инвестиции, развој и подобрување на конкурентноста на македонската индустрија, поддршка на



развојот на индустриско-преработувачките капацитети кои ќе бидат извозно ориентирани и ќе создаваат производи со повисока додадена вредност, подобрување на конкурентноста на туристичката понуда во земјата преку креирање на повolen бизнис амбиент и зголемена валоризација на културните и природните богатства, зголемување на бројот на туристи, раст на приходите од туризмот, со крајна цел зголемено учество на туризмот во вкупниот БДП на земјата.

Еден од клучните приоритети во наредниот период ќе биде и одржливо искористување на природните богатства, меѓу целите се зголемување на учеството на обновливите видови на енергија во финалната потрошувачка на енергија и заштита на животната средина и раст на инвестициите во енергетскиот сектор, интегрирање на пазарите на електрична енергија со земјите од регионот и земјите членки на ЕУ, планирање и одржливо користење на просторот и природните богатства.

Не, помалку од важно за Министерството за економија во наредниот период посебно откако Северна Македонија е членка во НАТО Алијансата и секако почетокот на преговорите со Европската унија е и јакнењето на позицијата на Република Северна Македонија во меѓународната заедница и унапредување на трговската соработка на билатерален, регионален и мултилатерален план, олеснување на пристапот на меѓународните пазари на стоки и услуги, либерализација на трговијата и намалување на бариерите, како и ефикасно спроведување на правото во делот на заштита на потрошувачите.

Реализација на овие цели, кои се во согласност со утврдените стратешки приоритети на Владата на Република Северна Македонија ќе придонесе во реализација на заложбите за посовремено, економски развиено општество со повисок животен стандард и задоволни граѓани.

Министерзаекономија

Kreshnik Bekteshi



Të nderuar,

Plani strategjik paraqet dokument kompleks dhe gjithëpërfshirës që në vete përmban masa dhe aktivitete të grupuara në programe dhe nënprograme, që janë në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike dhe në përgjithësi të Ministrisë së Ekonomisë, e me këtë edhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Planifikimi strategjik është vegël që ka fuqinë për të shndërruar në realitet vizionin e krijuar. Përmes planifikimit strategjik ky realitet tashmë shumë vite zbatohet me sukses në Ministrinë e Ekonomisë.

Me planifikimin strategjik, mundësohet realizim i prioriteteve, qëllimeve dhe aktiviteteve, që do të kontribuojnë për ekonomi të zhvilluar funksionale, që do të krijojë vende të reja të punës,



efikasitet më të lartë, produktivitet dhe aftësi konkurruese të kompanive, rritje të eksportit dhe të investimeve, standard më të lartë jetësor dhe jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Plani strategjik i Ministrisë së Ekonomisë në periudhën e ardhshme trevjeçare paraqet kornizë për krijimin e kushteve për zhvillimin e industrisë, e klasteringut, për përfshirjen e kompanive të Maqedonisë së Veriut në rrjetin e zinxhirëve global të furnizimit, krijimin e masave dhe aktiviteteve për krijimin e sektorit të zhvilluar sipërmarrës, integrimin e tregut kombëtar në tregun unik të BE-së, propozimin e politikave për sigurimin e stabilitetit dhe sigurisë energjetike, hulumtimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të lëndëve të para minerale, si dhe për zhvillimin e turizmit dhe hotelerisë, përmes përmirësimit të standardeve dhe të ofertës turistike.

Viteve të fundit janë bërë disa reforma kyçe në pjesën e përmirësimit të klimës së biznesit në vend, përmirësimin e kushteve për punë të kompanive të huaja, por edhe atyre vendore, si dhe në përmirësimin e klimës afariste për investime të reja në fushën e energjetikës, para së gjithash në pjesën që ka të bëjë me burimet përtëritëse të energjisë.

Të gjitha këto reforma janë bërë përmes dialogut të vazhdueshëm me bashkësinë e biznesit, me shoqatat afariste, por edhe të gjitha institucionet shtetërore që janë kreatorë dhe zbatues të politikave ekonomike, me njësitë e vetëqeverisjes lokale, bashkësinë akademike, por edhe me qytetarët.

Përmes dialogut tashmë janë përcaktuar edhe qëllimet në realizimin e të cilave tashmë jemi duke punuar në mënyrë aktive edhe në periudhën e ardhshme përmes programeve, projekteve, masave dhe aktiviteteve tona.

Cilat janë prioritetet e Ministrisë së Ekonomisë në periudhën e ardhshme?

Prioriteti kryesor është mbështetja financiare e kompanive me të cilën ato do të ndihmohen në përbaljen me pasojat shumëdimensionale nga pandemia e shkaktuar nga Kovid-19, nxitja e ndërmarrjeve që të dalin me zgjidhje krijuese për t'u përballur me sfidat zhvillimore që rezultojnë nga pandemia. Në përputhje me situatat e sapokrijuara me Kovid-19, janë përgatitur disa dekrete, si dhe masa dhe programe të reja me qëllim që të mbështetet sektori afarist në tejkalimin e efekteve negative nga kriza, të krijohet klimë e volitshme afariste për sektorin e biznesit, para së gjithash përmes mbështetjes së ndërmarrjeve vendore, me fokus kryesor në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hapjen e vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja, zhvillimin dhe përmirësimin e aftësisë konkurruese të industrisë së Maqedonisë së Veriut, mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve industriale-përpunuese që do të jenë të orientuar drejt eksportit dhe do të krijojnë produkte me vlerë më të lartë të shtuar, përmirësimin e aftësisë konkurruese të ofertës turistike në vend përmes krijimit të mjedisit të volitshëm për biznes dhe valorizimit të rritur të pasurive kulturore dhe natyrore, rritjen e numrit të turistëve, rritjen e të ardhurave nga turizmi, me qëllimin përfundimtar që është rritja e pjesëmarrjes së turizmit në PBB-në e përgjithshme të vendit.

Një nga prioritetet kryesore në periudhën e ardhshme do të jetë edhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore, e në mesin e qëllimeve janë rritja e pjesëmarrjes së llojeve përtëritëse të energjisë në sektorin energjetik, integrimi i tregjeve të energjisë elektrike me vendet e rajoni dhe vendet anëtare të BE-së, planifikimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të hapësirës dhe pasurive natyrore.

Jo më pak e rëndësishme për Ministrinë e Ekonomisë në periudhën e ardhshme, veçanërisht pasi Maqedonia e Veriut është anëtare e Aleancës së NATO-s dhe gjithsesi fillimit të bisedimeve me Bashkimin Evropian është edhe forcimi i



pozicionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkësinë ndërkombëtare dhe avancimi i bashkëpunimit tregtar në planin bilateral, rajonal dhe multilateral, lehtësimi i qasjes deri te tregjet ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve, liberalizimi i tregtisë dhe ulja e barrierave, si dhe zbatimi efikas i ligjit në pjesën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Realizimi i këtyre qëllimeve, që janë në përputhje me prioritetet e përcaktuara strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të kontribuojë në realizimin e angazhimeve për shoqëri më bashkëkohore, të zhvilluar në aspektin ekonomik, me standard më të lartë jetësor dhe qytetarë të kënaqur.

Ministër i Ekonomisë

Kreshnik Bektashi

HYRJE

Plani Strategjik si dokument strategjik afatmesëm, i lidhur ngushtë me procesin e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për periudhë trevjeçare, është instrument i rëndësishëm për planifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të Programeve në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë. I përpiluar në bazë të Vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022, Programi i punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.

MISIONI

Ministria e Ekonomisë punon në krijimin e kushteve për zhvillimin e industrisë, klasteringut dhe përfshirjen e kompanive maqedonase në rrjetin e zinxhirëve të furnizimit global, sektorin e zhvilluar sipërmarrës, krijimin dhe integrimin në tregun e vetëm në BE, sigurimin e stabilitetit dhe sigurisë energjetike, hulumtimin, eksplotimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të lëndëve të para minerale, zhvillimin e turizmit me përmirësimin e standardeve të ofertës turistike.

VIZIONI



Republika e Maqedonisë së Veriut me ekonomi të zhvilluar funksionale, që do të prodhojë vende të reja pune, efikasitet më të madh, produktivitet dhe aftësi konkurruese të kompanive, rritje të eksportit dhe rritje të investimeve, standard më të lartë jetësor dhe jetë më të mirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

DETYRA DHE OBLIGIME TË MINISTRISË SË EKONOMISË


Detyrat dhe obligimet e Ministrisë së Ekonomisë, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, kanë të bëjnë me:

- Propozimin e politikës proaktive industriale për rritjen e aftësisë konkurruese të prodhimtarisë industriale dhe zhvillimin e sektorëve të caktuar të industrisë;
- Zhvillimin dhe nxitjen e përgjegjesisë shoqërore;
- Nxitjen e investimeve përmes përmirësimit të klimës investuese;
- Rritjen e rregullimit të tregut të brendshëm dhe liberalizimit të çmimeve, vëzhgimin e lëvizjeve dhe kushteve në tregun e mallrave dhe shërbimeve dhe ndikimin e masave të politikës ekonomike në lëvizjet e tregut dhe marrëdhëniet e tregut; furnizimi i tregut me produkte ushqimore dhe produkte të tjera të konsumit të gjerë, mbikëqyrje të tregut dhe mbrojtje të konsumatorëve dhe të drejtave të tyre;
- Zhvillimin e sektorit energjetik, rritjen e efikasitetit energjetik dhe nxitjen e përdorimit më të madh të burimeve të ripërtërishme të energjisë, aftësinë konkurruese, sigurinë e furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Nxitjen e sipërmarrësisë dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë;
- Krijimin e kushteve për rritjen e eksportit përmes promovimit intensiv eksportues, bashkëpunimit shumëpalësh dhe dypalësh, regjimit të liberalizuar tregtar dhe krijimit të kornizës përkatëse rregullatore në përputhje me standardet e BE-së dhe kërkesat e OBT-së;
- Shfrytëzimin e burimeve minerale dhe jominerale natyrore;
- Zhvillimin dhe promovimin e turizmit dhe gastronomisë;
- Mbikëqyrjen administrative dhe çështje të tjera administrative të përcaktuara me ligj;
- Koordinimin e ndihmës së huaj dhe programeve të bashkësisë (KOSME).

SPECIFIKAT E MINISTRISË SË EKONOMISË

Ministria e Ekonomisë, sipas kompetencave të përcaktuara me ligj, sipas Misionit dhe Vizionit të përcaktuar të saj propozon dhe realizon programe dhe projekte që kanë të bëjnë me zhvillimin e shumë sektorëve jetik ekonomikë si industria, energjia, lëndët e para minerale, turizmi, sipërmarrësia, tregtia, tregu i brendshëm dhe mbrojtja e konsumatorëve, aktivitetet për integrim evropian dhe përgjegjësi shoqërore. Me këtë është përcaktuar specifika e Ministrisë së Ekonomisë për pjesëmarrje të rritur të programeve dhe projekteve horizontale krahasuar me organet tjera të administratës shtetërore. Qasja horizontale është në të njëjtën kohë e ndërkombëtarizuar. Ajo duhet të komunikojë edhe me strategjitë afatmesme të Bashkimit Evropian, duke siguruar qasje kombëtare. Kjo nga ana

tjetër, e thekson nevojën e avancimit të vazhdueshëm të koordinimit inter dhe intra dikasterial, bashkëpunim me bashkësinë e biznesit, organet e vetëqeverisjes lokale, odat ekonomike dhe institucionet shkencore.



**PRIORITETET DHE QËLLIMET E MINISTRISË SË EKONOMISË**

Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

- Mbështetja e ndërmarrjeve vendore, para së gjithash ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe zejtarët,
- Përmirësimi i mjedisit afarist për rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM),
- Ekosistemi dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacioneve,
- NVM konkurruese si bosht lëvizës i rritjes inkluzive ekonomike.

Zhvillimi dhe përmirësimi i aftësisë konkurruese të industrisë maqedonase dhe politikës investuese dhe përgjegjësisë shoqërore

- Zbatimi i politikës makroekonomike që synon ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe rritjen e punësimit;
- Krijimi i klimës së favorshme afariste me politika për bashkëpunim me sektorin e biznesit, partnerët socialë, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, mosdiskriminimin, efikasitet të rritur, transparencë të institucioneve dhe respektim të plotë të shtetit të së drejtës;
- Rritja dhe mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve industriale-përpunuese që janë të orientuara drejt eksportit dhe do të krijojnë produkte me vlerë më të lartë të shtuar, mbështetje e kapaciteteve industriale që do të mundësojnë zëvendësim të importit;
- Rritje të rritjes ekonomike dhe aftësisë konkurruese të industrisë në bazë të përhershme;
- Avancim i konceptit dhe praktikave të përgjegjësisë shoqërore;
- Zbatim i Strategjisë së përgjegjësisë shoqërore si program dhe politikë ekzistuese që synon mbështetjen e ambientit të favorshëm për zhvillimin e përgjegjësisë shoqërore në vend.

Zhvillimi i turizmit dhe gastronomisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Përmirësimi i aftësisë konkurruese të ofertës turistike në vend përmes krijimit të klimës së favorshme të biznesit dhe valorizimit të rritur të pasurive kulturore dhe natyrore;
- Digjitalizimi i ofertës turistike;
- Rritje e numrit të turistëve vendorë dhe të huaj, rritje e të ardhurave nga turizmi, me qëllimin përfundimtar për pjesëmarrjen e rritur të turizmit në PBB-në e përgjithshme të vendit;
- Rritja e ofertës turistike dhe ndërtimi i imazhit të dalluar turistik me vendosjen e standardeve botërore në shërbimet turistike-gastronome;
- Avancim i bashkëpunimit ndërkombëtar turistik;
- Mbështetje e destinacioneve turistike jashtë sezonit turistik;
- Klimë konkurruese biznesi për rritjen e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe vendeve të reja të punës në fushën e turizmit dhe gastronomisë;
- Zhvillimi i mëtejshëm i turizmit aktiv si potencial për zhvillim të fortë ekonomik lokal.

Planifikimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore



- Mundësimi i sigurisë në furnizimin me energji, rritja e investimeve në sektorin energjistik, integrimi i tregjeve të energjisë, vendosja e rrjeteve të mençura dhe mbrojtja e konsumatorëve të rrezikuar nga varfëria energjitike;
- Rritja e pjesëmarrjes së llojeve të energjisë së ripërtërishme në konsumin përfundimtar të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- Mundësimi i sigurisë dhe stabilitetit energjistik;
- Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike dhe rritja e investimeve në sektorin energjistik;
- Rritja e shfrytëzimit të gazit natyror dhe përdorimit të energjisë diellore në amvisëritë;
- Integrimi i tregjeve të energjisë elektrike me vendet e rajonit dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian;
- Hulumtimi, eksploatimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i lëndëve të para minerale;
- Planifikimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i hapësirës dhe pasurive natyrore dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale;
- Avancimi i kornizës ligjore në fushën e lëndëve të para minerale.

Krijimi i tregut unik – treg të brendshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut të harmonizuar përputhje me gjithë legjislacionin e Bashkimit Evropian

- Avancim i mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimi i cilësisë më të madhe të mallrave dhe shërbimeve në tregun maqedonas;
- Zbatimi efikas i së drejtës në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Avancimin e mbrojtjes së konsumatorëve përmes harmonizimit të mëtejshëm të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- Zbatimi efikas i së drejtës në pjesën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Arritjen e edukimit më të madh të konsumatorëve për realizimin e të drejtave të tyre, njoftim të tregtarëve me të drejtat dhe obligimet dhe mënyrën e mbrojtjes së interesave ekonomike;
- Rritja e besimit të konsumatorëve ndaj tregtarëve të mallrave dhe shërbimeve;
- Mbrojtja ligjore e konsumatorëve gjatë lidhjes së marrëveshjeve për kredi konsumatori si konsumator;
- Harmonizimi i legjislacionit teknik kombëtar në fushën e automjeteve me legjislacionin teknik për automjetet të BE-së për rregullimin e tregut të brendshëm, në përputhje me rregullativën e BE-së.

Zhvillimi i politikës efektive tregtare

- Krijimi i klimës së favorshme afariste me politikat e bashkëpunimit me sektorin e biznesit, mos-diskriminim, efikasitet dhe transparencë të rritur të institucioneve dhe respektimin e plotë të shtetit të së drejtës,
- Forcimi i pozicionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bashkësinë ndërkombëtare dhe përmirësimi i marrëdhënieve dhe forcimi i bashkëpunimit në planin dypalësh, rajonal dhe shumëpalësh,
- Lehtësimi i qasjes në tregjet ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve përmes lidhjes së Marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, liberalizimin e tregtisë në mallra

dhe shërbime dhe identifikimin dhe reduktimin e barrierave në tregtinë në kuadër të marrëveshjeve të lidhura,

- Forcimi i procesit të planifikimit, përgatitjes dhe vëzhgimit të realizimit të Programit Kombëtar për Miratimin e së Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) si dokument themelor strategjik programor në procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian,
- Implementimi i Planit shumëvjeçar të veprimit për fushën ekonomike rajonale- MAP REA.

PRIORITETET DHE QËLLIMET E MINISTRISË SË EKONOMISË KANË KUPTIMIN E NJËJTË

PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NË VITIN 2020/2021

PROGRAMI 1: PËRMIRËSIMI I KLIMËS AFARISTE DHE RRIJJA E AFTËSISË KONKURRUESE

Mbështetja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

Me Programin për aftësi konkurruese, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2020, për pjesën (A) të dedikuar për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë, fillimisht ishin parashikuar 37.740,000 denarë. Me ribalancimin e buxhetit për shkak të situatës me KOVID-19, këto mjete u zvogëluan në 22.040.000 denarë dhe të njëjtat u shfrytëzuan për realizimin e masave si vijon:

- Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (75 aplikime janë pranuar, nga të cilat 55 janë aprovuar)
- Mbështetje financiare për sipërmarrjen e grave (kanë mbërritur 23 aplikime, nga të cilat 11 janë aprovuar)
- Subvencionim i shpenzimeve për angazhimin e çirakëve (kanë mbërritur 2 aplikime, nga të cilat 1 është aprovuar)
- Subvencionim i shpenzimeve të zejtarëve (kanë mbërritur 46 aplikime, nga të cilat 43 janë aprovuar)
- Bashkëfinancim i projekteve të odave zejtare për zhvillimin dhe promovimin e zejtarisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (kanë mbërritur 7 aplikime/projekte, nga të cilat 4 janë aprovuar).

Nga programi P1 KOVID në Ministrinë e Ekonomisë, 20.000.000 denarë janë destinuar për mbështetjen e zejtarëve për përbalimin më të lehtë të pasojave nga Kovid 19. Për shkak të kësaj, janë bërë ndryshime në Programin e aftësisë konkurruese, inovacionit dhe sipërmarrësisë për vitin 2020 në fushën A, mbështetje dhe zhvillim i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë, me ç'rast u shtua masë e re - Bashkëfinancimi i shpenzimeve për zejtarët për blerje të veglave dhe repromaterialeve në vlerë të përgjithshme prej 20.000.000,00 denarë.



Lëndë e nënmasës ishte bashkëfinancimi i një pjese të shpenzimeve të zejtarëve për blerje të veglave dhe repromaterialeve përmes bashkëfinancimit deri në 60% të shpenzimeve të vërtetuara, por jo më shumë se 60.000,00 denarë individualisht për secilin aplikant.

Pas thirrjes publike kanë aplikuar gjithsej 234 aplikantë, ndërsa u subvencionuan gjithsej 225 zejtarë dhe ushtrues të veprimtarive zejtare me mjete në vlerë të përgjithshme prej 8.873.019 denarë.

Në vitin 2021 janë realizuar masat si vijon nga Programi për aftësi konkurruese, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2021, nga fusha A. Mbështetje dhe zhvillim i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zejtarisë:

- 1.1. Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla (276 aplikime të pranuar, 101 janë aprovuar dhe të njëjtat janë paguar),
- 1.2. Mbështetje financiare për sipërmarrësinë e grave (69 aplikime janë pranuar, nga të cilat 27 janë aprovuar dhe të njëjtat janë paguar),
- 1.4 Subvencionimi i shpenzimeve të zejtarëve (janë pranuar 95 aplikime, nga të cilat janë miratuar dhe paguar 89),

Për realizimin e masës 2.2 - Mbështetje financiare për certifikimin e sistemit HALLALL, më 01.07. të vitit 2021 është shpallur Thirrja publike dhe e njëjta zgjatë deri më 31.08. të vitit 2021.

Kanë mbërritur 13 aplikime, janë aprovuar 11 aplikacione në një vlerë të përgjithshme prej 1.539.328.

Për realizimin e masës 3.1 - Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve të ndërmarrjeve për blerjen e pajisjes, instrumenteve, vegla që do të shërbejnë dhe përdoren ekskluzivisht për trajnimin, mësimin e personave për të përvetësuar shkathtësi dhe kualifikime më 01.07. të vitit 2021 është shpallur Thirrje publike dhe e njëjta zgjatë deri më 30.07. të vitit 2021.

Kanë mbërritur 6 aplikime, janë aprovuar 5 aplikime me vlerë të përgjithshme 1.487.200.

Zhvillimi dhe përmirësimi i aftësisë konkurruese të industrisë maqedonase dhe politikave investuese dhe përgjegjësisë sociale:

- ✓ Në vitin 2019 janë realizuar aktivitetet për implementimin e dokumentit strategjik të politikës industriale, me plan veprimi për 2018-2020, përmes koordinimit me masat dhe programet rrjedhëse të Qeverisë.
- ✓ Përditësimi i vazhdueshëm i ueb faqes www.konkurentnost.mk;
- ✓ Mbështetje e politikave të klasterave dhe shoqatave të klasterave, përmes mbështetjes së projekteve për zhvillimin e tyre;
- ✓ Implementimi i masave nga Politika industriale, përmes Ministrisë së Ekonomisë realizohet përmes Programit vjetor për aftësi konkurruese, inovacion dhe sipërmarrësi. Në pjesën e Implementimit të politikës industriale, janë mbështetur subjektet afariste në funksion të rritjes së aftësisë së tyre konkurruese (mbështetje përmes kompensimit të një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste për zhvillimin e subjektit afarist, zhvillimin e produktit, zhvillimin e tregut), trajnime të specializuara rrënjësore, etj.;
- ✓ Në vitin 2019 u realizua bashkëpunimi me projekte nga donatorë që janë të lidhura me politikën industriale dhe zhvillimin e sektorit privat (Projekti i Bankës Botërore - Skills, Projekti për implementimin e Strategjisë së



- EJL-së 2020 - Grupi Punues i Politikës Industriale, Projekti GIZ për Kapitullin 20 - Ndërmarrjet dhe politikat industriale, bashkëpunimi me KE-në - Qendra e Përbashkët Hulumtuuese për specializimin e mençur, etj.);
- ✓ Zbatimi i Strategjisë së EJL-së 2020, gjatë vitit 2019 ka arritur përparim të rëndësishëm drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara në kuadër të 5 shtyllave, përmes përpjekjeve të fokusuara nga një numër i madh i faktorëve në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe implementim të Planit shumëvjeçar të veprimit (MAP) për formimin e zonës ekonomike rajonale në Ballkanin Perëndimor, si bazë e përbashkët për avancimin e bashkëpunimit ekonomik;
 - ✓ Në vitin 2019 zhvillohej komunikim i vazhdueshëm me KE-në përmes pjesëmarrjes në përgatitjen e NPAA Kapitullin 20 Ndërmarrje dhe politika industriale, pjesëmarrja e Nënkomitetit për tregti, doganë dhe industri, vëzhgim i vazhdueshëm i komunikimeve të reja të ndërlidhura me realizimin e strategjisë BE 2020, pjesëmarrje në përgatitjen e Programit ekonomik për reforma, pjesëmarrje në përpilimin e projekteve IPA, pjesëmarrje në përpilimin e strategjisë për specializim të mençur etj.;
 - ✓ Zhvillimi i politikave të klasteringut në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pjesë e politikës proaktive industriale, e cila synon rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë maqedonase. Klasterat kontribuojnë në masë të konsiderueshme në rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë maqedonase. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka rreth tridhjetë klastera në fusha të ndryshme;
 - ✓ Në vitin 2019 janë shpallur thirrje publike për bashkëfinancimin e organizimit të trajnimeve të specializuara - trajnime të detajuara dhe rrënjësore teknologjike në industrinë e përpunimit dhe janë përfshirë gjithnjë e më shumë sektorë industrialë: automobilistik, përpunimi i metalit, këpucëve, industria tekstile dhe ajo ushqimore, etj. Në vitin 2019 janë vendosur edhe trajnime të reja të specializuara për vendosjen e konceptit të gjelbërimit të industrisë dhe ekonomisë cirkulare në industrinë përpunuese, që janë realizuar me sukses.
 - ✓ Në vitin 2019, janë realizuar disa aktivitete lidhur me zbatimin e Planit të rritjes ekonomike, shtyllat 1 dhe 2 përmes Ligjit për mbështetje financiare të investimeve;
 - ✓ Në vitin 2019 u vazhdua me aktivitetet për harmonizimin e legjislacionit evropian me legjislacionin për produktet ndërtimore;
 - ✓ Në vitin 2019 është miratuar Strategjia afatmesme për përgjegjësi shoqërore të RMV-së 2019-2023 me Plan të veprimit Në bazë të pjesës II, fusha Ç, masa 1 - "Përgjegjësia shoqërore" nga Programi për aftësi konkurruese, inovacion dhe sipërmarrësi për vitin 2019, është shpallur thirrje publike për mbështetje për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zbatimin e praktikave të pranueshme sociale të subjekteve afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut (kanë mbërritur 4 aplikacione, nga të cilat 1 është aprovuar dhe paguar);
 - ✓ Është miratuar Strategjia afatmesme për përgjegjësi shoqërore të RMV-së 2019-2023 me Plan veprimi;
 - ✓ Kanë realizuar aktivitete promovuese për rezultatet bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar mes USAID-it dhe Ministrisë së Ekonomisë në fushën e përgjegjësive shoqërore të ndërmarrjeve, në kuadër të projektit Biznes Eko Sistem, nga Palladiumi;
 - ✓ Çmimi i 12-të kombëtar për PPSH më të mira Është organizuar çmimi i 12-të tradicional kombëtar për praktikat më të mira me përgjegjësi shoqërore të ndërmarrjeve maqedonase;



- ✓ Në vitin 2019 dhe 2020, janë dorëzuar vazhdimisht mendime ndaj kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë për interes publik për donacione ose sponsorizime, në përputhje me Ligjin për donacione dhe sponsorizime;
- ✓ Në vitin 2020, u vazhdua me implementimin e masave dhe aktiviteteve nga Plani i veprimit të Strategjisë për përgjegjësi shoqërore;
- ✓ Në bazë të pjesës II, fusha Ç - "Përgjegjësia shoqërore", masa 1 nga Programi për aftësi konkurruese, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2020, është publikuar thirrje publike për mbështetjen për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zbatimin e praktikave të pranueshme sociale të subjekteve afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut (kanë mbërritur 6 aplikime nga të cilat janë aprovuar dhe paguar 5);
- ✓ Implementimi i Strategjisë industriale 2018-2027;
- ✓ Implementimi i Programit për aftësi konkurruese, inovacione dhe sipërmarrësi për vitin 2020 (thirrje e shpallur publike, vlerësim i aplikimit, procedurë për ndarjen e mjeteve, etj);
- ✓ Në përputhje me situatat e reja me KOVID 19, janë përgatitur disa urdhëresa dhe masa dhe programe të reja me qëllim të mbështetjes së sektorit afarist në tejkalimin e efekteve negative nga kriza;
- ✓ Aktivitetet e mëtejshme në zhvillimin e Strategjisë së specializimit të mençur, përgatitja e kontributeve në NPAA Kapitulli 20, përgatitja e propozim projekteve për IPA programim, pjesëmarrje në përpilimin e MAP REA-s së re
- ✓ Komunikimi i vazhdueshëm me sektorin e biznesit;
- ✓ Mbështetje e vazhdueshme administrative për realizimin e investimeve në ZZHTI Tetovë (partneritet publik-privat);
- ✓ Zbatohen konsultime të vazhdueshme me Trupin koordinues për përgjegjësi shoqërore të ndërmarrjeve;

Mbështetja dhe zhvillimi i turizmit dhe gastronomisë:

- ✓ Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dypalësh në turizmin;
- ✓ Sinjalizimi i vendosur turistik në territorin e gjithë shtetit;
- ✓ Shtypja e materialeve promovuese
- ✓ Shënim i Ditën botërore të turizmit me ndarjen e mirënjohjeve për më të suksesshmit në fushën e turizmit, 50 ndërmarrje morën mirënjohje për sukses;
- ✓ Mbështetje e turizmit vendor për punëtorë me të ardhura të ulëta në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2020 janë lëshuar 117.000 vërtetime (vauçerë) për punëtorë me të ardhura të ulëta në vlerë prej 6.000,00 denarë, prej të cilave janë shfrytëzuar 67.000 në objekte gastronomike (hotele) në gjithë shtetin;
- ✓ Furnizimi i aplikacionit celular "Visit Macedonia".

PROGRAMI 2: SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE (pasurive) NATYRORE

Zhvillimi i energjetikës:

- ✓ U miratua Ligj i ri i efikasitetit energjetik,



- ✓ Raport për sigurinë në furnizimin e gazit natyror Ministria e Ekonomisë në korrik të vitit 2018 përpiloi dhe publikoi Raport për sigurinë në furnizimin me gaz natyror, që i dorëzohet Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike,
- ✓ Është përpiluar Plan kombëtar për energji dhe klimë deri në vitin 2030, janë mbajtur disa takime të grupit të punës dhe nëngrupeve të punës dhe është zhvilluar debat publik me draft Raport për VSMJ,
- ✓ Është hartuar propozim Program për realizimin e strategjisë për zhvillimin e energjetikës në vitet 2021-2025,
- ✓ Është përpiluar propozim Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energjetikë në përputhje me Direktivat dhe Rregullativat e reja,
- ✓ Është përpiluar propozim Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për investime strategjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me Rregullativën 347/2011,
- ✓ Është përpiluar Urdhëresë për cilësi të karburanteve të lëngshme dhe është dorëzuar në Qeveri për miratim,
- ✓ Miratim i bilancit energjetik - Ministria e Ekonomisë ka përpiluar Bilancin energjetik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Bilancin energjetik për vitin 2021,
- ✓ Në fillim të viteve 2020 dhe 2021, u miratuan: Programi për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe nxitja e efikasitetit energjetik. Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të rrezikuar të energjisë dhe Programi për mbështetje financiare për prodhimin e energjisë elektrike,
- ✓ Është marrë Vendim për fillimin e procedurës së tenderimit me ankand për ndarjen e premive për energji elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike të ndërtuara në truall që nuk është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose në truall në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilin është vendosur e drejtat e shfrytëzimit të kapacitetit të përgjithshëm të instaluar deri 80 MW,
- ✓ Ministria e Ekonomisë filloi përgatitjet e akteve vijuese nënligjore nga fusha e efikasitetit energjetik që rezultojnë nga Ligji i ri për efikasitet energjetik,
- ✓ Rregullore për karakteristikat energjetike të ndërtesave,
- ✓ Rregullore për kontrollin energjetik të ndërtesave,
- ✓ Listë tarifore për kontrollin energjetik të ndërtesave,
- ✓ Rregullore për kontrollin energjetik te tregtarët e mëdhenj,
- ✓ Listë tarifore për kontrollin energjetik te tregtarët e mëdhenj,
- ✓ Rregullore për shënimin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera që përdorin energji,
- ✓ Urdhëresë me të cilën përcaktohet Skema obligative për efikasitet energjetik,
- ✓ Rregullore për MVP,
- ✓ Ministri i Ekonomisë i miratoi edhe aktet nënligjore si vijon,
- ✓ Rregullore për nivelin dhe mënyrën e përlogaritjes së rezervave operative të derivateve të naftës dhe karburanteve për transport,
- ✓ Rregullore për kushtet për evidentimin e sasive dhe kapacitetit të nevojshëm të objekteve për magazinimin e naftës së papërpunuar, derivateve të naftës, biokarburanteve ose karburanteve për transport,



- ✓ Janë lëshuar Vërtetime për trajtuesit e lloje të veçanta të pajisjeve dhe impianteve energjetike dhe Autorizimeve për kontrollor energjetik sipas Ligjit për ndryshimin e Ligjit për efikasitet energjetik,
- ✓ Është përpiluar draft version i Ligjit të biokarburanteve, janë mbajtur disa takime të grupeve të punës, ndërsa debat publik do të mbahet në gusht, pas çka pritet miratimi i ligjit deri në fund të vitit.

Programe dhe projekte

Programi për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe nxitjen e efikasitetit energjetike në amvisëritë për vitin 2020 u realizuar vetëm për soba të blera dhe të instaluar me peleta, e për shkak të krizës së re të krijuar me virusin KOVID -19, mjetet tjera janë ridedikuar në fondin për përballje me pandeminë. Për vitin 2021 janë realizuar tërësisht mjetet e parashikuara prej 52.000.000,00 dhe në mënyrë plotësuese me ridedikimin janë siguruar edhe 7.460.000,00 dhe planifikohet t'u paguhen kërkuesve që i përmbushin kushtet e parashikuara në programet.

Shfrytëzim i qëndrueshëm i lëndëve të para minerale:

- ✓ Përpilimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për lëndët e para minerale,
- ✓ Miratimi i Listës së re tarifore për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për dhënie e lejeve dhe koncesioneve për ushtrimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike dhe koncesioneve për eksploatimin e lëndëve të para minerale që rezultojnë nga Ligji për lëndët e para minerale,
- ✓ Mirëmbajtja e veglave softuerike - GIS,
- ✓ Mirëmbajtja e sistemit e-koncesione për ndarjen e koncesioneve me ankand elektronik,
- ✓ Zbatimi i disa procedurave (tenderëve) për ndarjen e koncesioneve për hulumtime të detajuara gjeologjike dhe eksploatimin e lëndëve të para minerale,
- ✓ Përpilimi i Lejeve për hulumtime të detajuara gjeologjike dhe për eksploatimin e lëndëve të para minerale.
- ✓ Lëshimi i Autorizimeve për përpilimin e dokumentacionit gjeologjik dhe projekteve minerare,
- ✓ Zbatim të dhënies së provimeve profesionale për marrjen e Licencave për përpilimin e dokumentacionit gjeologjik, realizimin dhe mbikëqyrjen e hulumtimeve gjeologjike.

PROGRAMI 3: KRIJIMI I TREGUT UNIK TË BRENDSHËM

- ✓ Është përgatitur Ligj i ri për mbrojtjen e konsumatorëve në përputhje me direktivat më të reja të BE-së,
- ✓ Është implementuar Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2020, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe janë ndarë mjete për realizimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2021.

Është përgatitur Ligj i ri për kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësimin e konfirmimit dhe draft rregullore në raport me këtë ligj:



- ✓ Rregullore për përputhshmërinë elektromagnetike
- ✓ Rregullore për pajisje të tensionit të ulët - LVD
- ✓ Rregullore për pajisje nën presion,
- ✓ Rregullore për enë të thjeshta nën presion
- ✓ Rregullore për pajisje portative nën presion,
- ✓ Rregullore për pajisje RTT
- ✓ Rregullore për lundruese rekreative,
- ✓ Rregullore për ATEH - atmosferë potenciale shpërthyesë,
- ✓ Rregullore për ashensorë,
- ✓ Rregullore për qasje në treg dhe kontroll të tregut të eksplozivëve për përdorim civil
- ✓ Rregullore për pajisje të djegshme nën gaz.

PROGRAMI 4: KRIJIMI I POLITIKËS EFEKTIVE TREGTARE

- ✓ Është zbatuar analizë e detajuar e harmonizimit të rregullave me direktivën e BE-së për shërbime 32006L0123 dhe Ligjin për shërbime;
- ✓ Është rishikuar dhe miratuar Plani i veprimit për harmonizim me Direktivën e BE-së për shërbime 32006L0123 dhe Ligjin për shërbime;
- ✓ Në implementimin e Planit të veprimit për harmonizim me direktivën për shërbime/ligjin për shërbime, janë ndryshuar një numër i madh i akteve juridike me çka janë eliminuar barrierat e paarsyeshme për qasje dhe dhënie të shërbimeve në vend dhe u modernizua korniza rregullatore në shërbimet;
- ✓ Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari turistike (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.31/2020) është bërë harmonizimi me nenin 14 të direktivës (është hequr ndaluar kërkesa për nënshtetësi për ciceronët turistik për ofrues të shërbimeve EEP) dhe është bërë harmonizimi me nenin 16 të direktivës (u mundësua ofrimi i përkohshëm dhe kohëpaskohshëm i shërbimeve në vend për ofruesit e shërbimeve nga EEP)
- ✓ Ka filluar IPA Projekti "Forcim i tregut të brendshëm" (EuropeAid/140492/DH/SER/MK) në kornizat e të cilit në komponentin 2 janë parashikuar aktivitete për avancimin e kornizës ligjdhënëse dhe institucionale për implemetimin efektiv të së drejtës së BE-së në fushën e qarkullimit të lirë të shërbimeve;
- ✓ Është bërë harmonizimi plotësues me Direktivën e BE-së për bashkim ndërkufitar, si dhe harmonizim të pjesëshëm me Direktivën e BE-së për kontabilitet, në kuadër të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëri tregtare (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 290/20);
- ✓ Është realizuar pjesëmarrje në mbledhjet e rregullta të Komitetit të furnizimit publik në vitet 2020 dhe 2021, me prani dhe mbledhje virtuale;
- ✓ Janë mbajtur mbledhjet e Komitetit kombëtar për lehtësimin e tregtisë (NTCF);
- ✓ Është mbështetur propozimi në lidhje me tekstin e punës për nenin VI:4 të GATS-it, me të cilin përpunohen disiplina për rregullativë vendore në shërbimet, si pjesë e iniciativave në OBT për praktikë të mirë rregullatore në tregtinë e shërbimeve;
- ✓ Janë ndërmarre aktivitete për përmirësimin e mëtejshëm të lehtësimit të tregtisë dhe biznesit;



- ✓ Janë dorëzuar Notifikime në OBT pas Marrëveshjes së qasjes në treg, Marrëveshja për bujqësi;
- ✓ Marrëveshja për rregullat e origjinës dhe Marrëveshja për masa fitosanitare;
- ✓ Është miratuar Protokollin plotësues 6 për tregti me shërbime;
- ✓ Është miratuar Vendim i Komitetit të përbashkët të CEFTA-s për ndryshimin e Aneksit 4 të Marrëveshjes së CEFTA-s që ka të bëjë me Protokollin lidhur me përkufizimin e produkteve me origjinë dhe metoda të bashkëpunimit administrativ;
- ✓ Është ratifikuar Protokollin plotësues 6 për tregti me shërbime më 5 dhjetor të vitit 2020 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 291/20;
- ✓ Startuan bisedimet për Protokollin plotësues 7 për zgjidhjen e kontesteve në nivel të CEFTA-s;
- ✓ Kanë filluar bisedimet për lidhjen e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale;
- ✓ Implementim i Marrëveshjes për lehtësimin e tregtisë në CEFTA (është miratuar Vendimi për Operatorë të autorizuar ekonomikë dhe hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2020, është miratuar vendimi i CEFTA-s për pemë dhe perime dhe hyri në fuqi, është implementuar sistemi SEED + dhe është miratuar Strategjia për menaxhimin e rreziqeve);
- ✓ Është miratuar dhe aprovuar Vendimi i Komitetit të përbashkët EFTA - Republika e Maqedonisë së Veriut për Ndryshimin e Protokollit B ndaj Marrëveshjes së tregtisë së lirë mes shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Maqedonisë që ka të bëjë me përkufizimin e konceptit produkte me prejardhje dhe metodat e bashkëpunimit administrativ;
- ✓ Janë bërë ndryshime të Marrëveshjes për produkte bujqësore me Konfederatën Zvicerane, ndryshime të Protokollit për bujqësi me Mbretërinë e Norvegjisë dhe ndryshime të Protokollit për bujqësi me Islandën;
